



REPUBLIKA KOSOVA
DEPARTAMENTI I PROKURORISE
THELORE GJILAN-DEGA NE NOVOBERDE
PROKUROR I PLOTFUQISHEM
08.06.2017

P.nr. 1/2016

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega ne Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Hasan Sadiku me procesmbajtësen Fjolla Huruglica në qështjen penale kundër të akuzuarve N B , fshati , të cilin e mbrojnë av. Sabit Maliqi nga Gjilani përshkak të veprave penale pengim i personit zyrtar në kryrje të detyrave zyrtare nga neni 49 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, lenim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1, 4 të KPRK-ës dhe asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-ës , të akuzuarve A 3 , A B , N B dhe I B te gjithë nga fshati Kk Novobërdë për shkak të veprës penale pengim i personit zyrtar në kryrje të detyrave zyrtare nga neni 409 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 2 dhe me nenin 31 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.940/2013 të datës 14.06.2013 , të cilën e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit, Mr.sc. Ismet Ukshini , pas mbajtjes së seancave gjyqësore më datë 06.06.2016 , 04.07.2016, 08.08.2016, 19.09.2016, 10.10.2016, 14.11.2016 , 12.12.2016, 16.01.2017 ndërsa më datë 17.01.2017 publikisht shpalli këtë;

Akt gjykim

1.I akuzuari N B pa pseudonim dhe emër të rrejtshëm , nga babai dhe nëna , e lindur P. , lindur ne fshatin , ku edhe jeton, Shqiptar , Shtetas i Republikës së Kosovës , ka të kryer shkollën fillore , bujk , i martuar , baba i pesë fëmijëve , i gjendjes së varfër ekonomike deri më tani i pa dënuar dhe nuk zhvillohet procedur tjetër penale ndaj tij.

2.I akuzuari A F pa pseudonim dhe emër të rrejtshëm , nga babai F dhe nëna H , e lindur F , lindur në fshatin , ku edhe jeton, Shqiptar , Shtetas i Republikës së Kosovës , ka të kryer shkollën fillore , bujk , i martuar , baba i tre fëmijëve , i gjendjes së varfër ekonomike deri më tani i pa dënuar dhe nuk zhvillohet procedur tjetër penale ndaj tij.

3.I akuzuari A B pa pseudonim dhe emër të rrejtshëm , nga babai S. dhe N K. , e lindur H , lindur ne fshatin , ku edhe jeton, Shqiptar , Shtetas i Republikës së Kosovës , ka të kryer shkollën fillore , Bujk , i martuar , baba i tre fëmijëve , i gjendjes së varfër ekonomike deri me tani i pa dënuar dhe nuk zhvillohet procedur tjetër penale ndaj tij.

4.I akuzuari N F pa pseudonim dhe emër të rrejtshëm , nga babai H dhe Nena H , e lindur F , lindur në fshatin , ku edhe jeton, Shqiptar , Shtetas i Republikës së Kosovës , ka të kryer shkollën fillore , i pa pune, i martuar

,baba i tre fëmijëve ,i gjendjes së varfër ekonomike deri me tani i pa dënuar dhe nuk zhvillohet procedur tjetër penale ndaj tij.

5.I akuzuari L B pa pseudonim dhe emër të rrejshëm ,nga babai A dhe Nena A ,e lindur P ,lindur 01.01.1989 në fshatin . ku edhe jeton,Shqiptar ,Shtetas i Republikës së Kosovës ,ka të kryer shkollën mesme ,i pa pune, i pa martuar ,i gjendjes së varfër ekonomike deri më tani i pa dënuar dhe nuk zhvillohet procedur tjetër penale ndaj tij.

Të akuzuarit: N B ,A B ,A B i ,N B dhe L B ;

Janë fajtor

I.

Sepse me datë 18.05.2013 , rreth orës 19:30 min. në fshatin të K.Novobërdës te vendi i quajtur mulliri i "dostiqeve" kan marr pjesë në grupe të personave që me veprim të përbashkët kanë penguar personat zyrtar: Jovan Stojanoviq, Sejdi Gajtani dhe Dragan Jankoviq , Polic të Stacionit të Policisë Novobërdë, në atë mënyrë që të gjithë i vërsulen F F nga fshati P , duke e fyer dhe duke tentuar që ta nxjerrin nga kombi për ta rrahur edhe pse tani i dëmtuari ishte nën përkujdesjen –përcjelljen e personave zyrtar të lartë cekur për ta dërguar në stacionin policor për ta marrur në pyetje përshak të veprës penale të Vjedhje pylli.

Me qka në bashkëveprim si bashkekzekutor kanë kryer veprën penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 paragrafi 5 lidhur me paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

I akuzuari N B

II.

Sepse ditën ,vendin dhe kohën e përmendur si në dispozitivin e këtijë aktgjykimi i ka shakaktuar lëndime të lehta trupori të dëmtuarit F F nga fshati K.Novoberde ,ne ate menyre qe këtij ia merr nga dora nje dru dhe me te njëjtin godet ne kokë mbi vetullën e majtë dhe me këtë rast i shkakton lëndime të lehta trupore ne formë të përshkruar si në raportin mjekësor të Emergjensës të Spitalit Regjional me nr. 8562 të datës 18.05.2013 .

Me qka ka kryer veprën penale lëndim i leht trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-ës.

III.

Sepse ditën ,vendin dhe kohën të cekur si ne dispozitivin I. te këtij aktgjykimi të dëmtuarit F . Fj nga fsh. , ia ka dëmtuar kombin e markës '' Ford Tranzit '' me targa te regjistrimit () në atë menyre qe se pari e godet me nje dru(shkop) xhamin e dritaresshoferit te kombit ne fjalë e më pas atë e gjuan edhe nga mbrapa dhe me ate rast ia then edhexhamin e pasem dhe ne kete menyre ketije te dëmtuari i shakton nje dëm për ato dy xhama të thyer te nje vlere te papërcaktuar .

Me qka ka kryer vepër penale asgjesimi spo dëmtimi i pasuris nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Andaj gjykata merr në bazë të dispozitave te nenit 4 ,31,41,51,64,73,74,75, 76 , dhe nenit 80 të KPRK-ës lidhur me nenin 365 të KPPK-ës.

Të akuzuarve: N E , A B , N E A B dhe L B

I'U SHQIPTON DËNIM ME KUSHT

I.Të akuzuarit N B

Per veprën penale si në dispozitivin I. pengim i personit zyrtar në kryrjen e detyrave zyrtare nga neni 409 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-ës me dënim me kusht në kohëzgjatje prej nga 8(tetë)muajve .

Për veprën penale të cekur si në dispozitivin II. ,lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nen paragrafi 1,4 të KPRK-ës me dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 3(tre) muajve .

Për veprën penale të cekur në dispozitivin III.asgjesimi apo dëmtimi i pasurisë neni 333 paragrafi 1 të KPRK-ës me dënim me burgim me kusht ne kohëzgjatje prej 2(dy)muajve

Andaj gjykata konform dispozitës se neni 80 të KPPK-ës , të akuzuarin Nazmi Beqiri

E G J Y K O N

Me dënim unik me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1(një) viti, i cili dënim ndaj të akuzuarit nuk ka për të ekzekutuar në qoftese në afat prej dy viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale ,në të kundërtën dënimi me kusht ka per tu revokuar.

II.Të akuzuarit A B , A B , N B dhe L B për veprën penale të cekur si në dispozitivin I.pengim i personit zyrtar ne kryrje të detyrave zyrtar nga neni 409 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 2 lidhur me neni 31 te KPRK-ës, me dënim burgu secilin në kohëzgjatje prej nga 8 (tetë) muaj i cili dënim nuk ka për tu ekzekutuar në qoftese të akuzuarit në afat prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryejn ndonjë vepër tjetër penale në të kundërtën dënimi me kusht ka për tu revokuar .

III. I dëmtuari F. ... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

IV. Obligohen të akuzuarit që ti paguajn shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor secili veq e veq shumën prej nga 25 €, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kercënim të përmbarimit të dhunshëm .

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP.II.nr 940/2013 të datës 14.06.2013 i ka akuzuar N. B. , A. B. , N. B. dhe L. B. te gjithë nga fshati ... Novobërdë përshkak të veprës penale të kryer në bashkveprim si bashkekzekutor pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës dhe të akuzuarin Nazmi Beqiri ,përshak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-ës dhe veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasuris nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Prokurori i Shtetit Mr.sc. Ismet Ukshini, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: në tërsi mbetem pranë aktakuzës së ushtruar me shkrim pasi që në këtë qështje penale gjendja faktike u vërtetua edhe me pranimin e fajsis së të akuzuarve dhe se ky pranim i fajsisë është në përputhshmerin të plotë me provat e propozuara nga ana e Prokuroris së Shtetit për vërtetimin e drejt dhe të plotë të gjendjes faktike. Andaj, propozoj që të akuzuarit të shpallen fajtor për veprat e kryera, dhe të dënohen sipas ligjit, gjithnjë duke i marrur për bazë të gjitha rrethanat rënduse dhe ato lehtësuese .

Mbrojtësi i të akuzuarit N. B. Av.Sabit Maliqi në fjalën përfundimtare ka deklaruar:pas ballafaqimit me aktakuzën e Prokurorisë dhe provave materiale si dhe dëshmisë së dëshmitarëve,pas një konsultimi të gjërë me të mbrojturin tim N. B. i njëjti ka pranuar fajsinë për tri vepra penale te cilat ia vë në barrë aktakuza dhe se ky pranim i fajsisë është bërë nga vullneti i lirë pa ndonjë ndikim andaj ,i propozoj gjykatës që me rastin e matjes së dënimit ti marr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, si paranimin e fajsis ,pendimin për veprat e kryera si dhe gjendjen shëndetësore të të akuzuarit pasi që i njëjti është lëngon nga sëmundja kardiovaskulare dhe me terapi mjeksore ,andaj propozoj që të njëjtit ti shqiptohet nje dënim sa me i lehtë dhe atë i kushtëzuar.

I akuzuari N. B. në fjalën përfundimtare ka deklaruar :e ndiej veten fajtor për veprat penale të cilat mi vë në barrë aktakuza ,pendohem dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin dhe i propozoj gjykatës që të ma shqiptoj një dënim sa më të butë.

Të akuzuarit A. B. ,A. B. ,N. B. dhe I. B. në fjalën përfundimtare kanë deklaruar se ndiejm veten fajtor dhe e pranojm fajsinë për veprën penale të

cilat na i vë në barrë aktakuza jemi te njoftuar per pasojat dhe benefitet e pranimit te fajsisë ,se kete pranim te fajsisë e bëjmë pa kurfar ndikimi dhe shtrëngimi, pendohemi mpër kryerje e kësaj veprë penale dhe i premtojm gjykatës që në të ardhmen nuk do të ndërrmarim kurnifar veprimi kundër ligjor ,andaj edhe i propozoj gjykatës që të na i shqiptoj një dënim sa më të butë .

Meqense të akuzuarit në këtë qështje penale e kanë pranuar fajsin për të gjitha pikat e aktakuzës e me këtë sipas vlersimit të kësaj gjykate , gjendja faktike në këtë qështje penale nuk është kontestuse, sepse përveq pranimit të fajsis nga ana e të akuzuarve për veprat e kryera ,një pranim i till ka mbështetje edhe në provat e grubulluara të cilat gjenden në shkresat e lëndes dhe se të gjithë të akuzuarit vullnetarisht e kanë pranuar fajsin ,se e kanë kuptuar pasojat e pranimit të fajsis dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo ndonjë gabimi teknik ,andaj gjykata në pajtim me nenin 826 paragrafi 4 pa shtjellimin e provave vazhdoj shqyrtimin gjyqësor me fjalën përfundimtare.

Me rastin e përcaktimin për llojin dhe lartësin e dënimit për të akuzuarit N B , A B A B ,N B dhe L B gjykata i ka marr parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rënd,ashtu sic e parasheh dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-ës. Kështu si rrethan lehtësuese për të akuzuarin N B gjykata mori parasysh pranimin e fajsis për të gjitha pikat e aktakuzës qka do të thotë se i akuzari më në fund ka pranuar të jetë bashkpunues ,se i njëjti është penduar për kryerjen e veprave penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do te bie ndesh me ligjin ,se i njëjti është i gjendjes së rëndë shëndetsore dhe se i njëjti vuan nga sëmundja kardiovaskulare .

Gjithashtu edhe për të akuzuarit A I ,A L ,N B dhe L B gjykata mori si rrethan lehtësuese faktin se të njëjtit e kanë pranuar fajsinë janë penduar për kryerjen e kësaj veprë penale dhe se i kanë premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do te ndërmarrin veprime te tilla apo te ngjajshme kundër ligjore, se te njëjtit janë te gjendjes se varfer ekonomike se eshte hera e pare se te njëjtit kane rene ndesh me ligjin .Ndersa si rrethan rënduse për të akuzuarit gjykata pati parasysh shkallen e përgjegjesis penale ,rrezikshmërinë shoqërore të kryerjes së këtyre verpave penale, sepse të njëjtit si bashkekzekutor kanë penguar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ashtu që i janë vërsulur tani të dëmtuarit Fitim Fejzullahu i cili ka qenë i ndalur nga pjestarët e policisë të cilët e kanë pasur nën kujdesje – përcjelljen e të njëjtit për në stacionin e policisë për ta marr në pyetje përshak të veprës penale Vjedhja e pyellit .

Nga një gjendje e këtillë faktike e vërtetuar gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarve qëndrojnë të gjitha elementet e veprave penale të cekura si më lart për qka edhe të akuzuarit i shpalli fajtor dhe iu shqiptoj dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi ,me bindje se dënimet e shqiptuara për të akuzuarit janë në harmoni të plotë me përgjegjësit e tyre dhe peshën e veprave penale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit, ashtu që të akuzuarit ti parandaloj që në të ardhmen të mos të kryejn verpa tjera penale dhe kështu do të ndikoj edhe tek qytetaret tjerë që në të ardhmen të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Venimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor është i mbështetur në dispozitën e nenit 450 paragrafi 1 të KPPK-ës.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është e bazuar në dispozitën e nenit 463 paragrafi 1 të KPPK-ës.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtijë aktgjykimi .


Gjykata Themelore në Gjiilan -Dega Novobërdë

Departamenti i përgjithshëm

P.nr 1/2016 ,më datë 17.01.2017

Procesmbajtesja,

Fjolla Huruglica



Gjyqtari,

Basim Sadiku

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

